

AKT THEMELIMI
SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GARAZHI”

TIRANË, SHQIPËRI

DATË 03.10.2023

Sot, në Tiranë, më datë 03.10.2023, unë **Z. Denis ORMËNAJ**, i biri i Syrjait dhe Anilës, lindur në Kuçovë, i datëlindjes 25.01.2002, me nr.personal K20125002S, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile beqar, dhe unë **Z. Gerti DOKAJ**, i biri i Rizait dhe Lauretës, lindur në Tiranë, i datëlindjes 18.02.2002, me nr.personal K20218046A, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me gjendje civile beqar, me dëshirë të lirë dhe me vullnet të plotë e të pavesuar, deklarojmë se kemi hartuar aktin e themelimit të shoqërisë “**GARAZHI**” **sh.p.k**, bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, dhe ligjin nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.



NENI 1

FORMA E SHOQËRISË

Formohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (**sh.p.k**), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, me ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, i ndryshuar, me ligjin nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, si dhe me përcaktimet e këtij akt themelimi dhe statuti.

NENI 2

EMRI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë është “**GARAZHI**” **sh.p.k**. Shoqëria do të përdorë vulën e saj në të gjitha korrespondencat dhe/ose në të gjitha dokumentet e saj, e cila do të përbëhet minimalisht nga emri i shoqërisë, nga NIPT dhe nga çdo karakteristikë tjetër e nevojshme për shoqërinë në komunikim me palë të treta. Themeluesit kanë zgjedhur emrin e shoqërisë në marrëveshje me njëri-tjetrin. Ky emër është i lirë, nuk është i regjistruar, apo i bllokuar në regjistrin tregtar.

NENI 3

ORTAKËT E SHOQËRISË

Shoqëria “**GARAZHI**” sh.p.k themelohet dhe krijohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 2 (dy) ortakë. Ortakët e shoqërisë “**GARAZHI**” sh.p.k janë:

1. **Z. Denis ORMËNAJ**, i biri i Syrjait dhe Anilës, lindur në Kuçovë, i datëlindjes 25.01.2002, me nr.personal K20125002S, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile beqar.
2. **Z. Gerti DOKAJ**, i biri i Rizait dhe Lauretës, lindur në Tiranë, i datëlindjes 18.02.2002, me nr.personal K20218046A, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me gjendje civile beqar.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm është i detyruar ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën, në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.



NENI 4

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k ndodhet me adresë: “**Rruga Llazi Miho, Njesia Administrative Nr.6, Kombinat, Tiranë**”. Transferimi i selisë së shoqërisë në një tjetër adresë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, duke bërë regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, si dhe duke bërë njoftimet e tjera sipas legjislacionit në fuqi (administratën tatimore qendrore dhe vendore). Shoqëria mund të vendosë të hapë brenda dhe jashtë vendit, degë dhe/ose zyra përfaqësimi, duke bërë regjistrimet e nevojshme sipas legjislacionit shqiptar dhe/ose të huaj në fuqi për këtë qëllim.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Shoqëria “GARAZHI” sh.p.k ka si objekt të veprimtarisë së saj, por pa u kufizuar, si vijon:

“Projektim, zhvillim, mirembajtje dhe testim i sistemeve software, te komunikimit dhe te sigurise. Importim, eksportim dhe tregtim te sistemeve te teknologjise se informacionit per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve si: hardware, software, networking dhe te gjithe periferikeve te tyre. Sherbime marketingu, menaxhimi, konsulence, trajnimi e ndermjetesimi per individe apo shoqeri qe kryejne aktivitetin e tyre brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Per realizimin e objektit te aktivitetit te saj, shoqeria mund te bleje dhe te shese pasuri te luajtshme dhe/ose te paluajtshme, te kryeje cdo lloj operacioni: financiar aktiv e pasiv, te ndermarre e te zhvilloje cdo lloj aktiviteti industrial, tregtar, qe konsiderohen te dobishme, te pershtatshme, si dhe fitimprurese per shoqerine ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe/ose me legjislacionin e huaj ne fuqi per kete qellim.”

Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, shoqëria mund të blejë dhe të shesë pasuri të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, të kryejë çdo lloj operacioni financiar aktiv e pasiv, të ndërmarrë e të zhvillojë çdo lloj aktiviteti industrial, tregtar, që konsiderohen të dobishme, të përshtatshme, si dhe fitimprurëse për shoqërinë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe/ose me legjislacionin e huaj në fuqi për këtë qëllim. Sipas interesit të ortakut dhe/ose të ortakëve të saj, shoqëria mund të ushtrojë aktivitete tregtare fitimprurëse të tjera nga ato të përcaktuara në këtë nen, duke respektuar paraprakisht çdo kërkesë ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim. Shoqëria mund t’i kryejë aktivitetet e përmendura më sipër (si dhe ato të papërmendura dhe të lejuara në bazë të legjislacionit në fuqi) në sektorin publik, të administratës publike, si dhe në sektorin privat. Aktivitete të tilla mund të kryhen nga shoqëria si drejtpërdrejt, ashtu edhe nëpërmjet subjekteve të treta me qëllimet e dhëna ose pjesëmarrëse ose të kontrolluar. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në bazë të dispozitave të aktit të themelimit, të statutit, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, shoqëria mund të marrë drejtpërdrejt ose indirekt, interesa ose pjesëmarrje, duke përfshirë edhe ato aksionare, në shoqëri dhe/ose në ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri dhe/ose në vende të tjera jashtë Shqipërisë, që kanë objekt të ngjashëm, të njejtë ose kanë lidhje me objektin e saj, me qëllim fitimprurës. **Shoqëria nuk ka për të kryer asnjë aktivitet, pa**

marrë paraprakisht lejet apo licencat e nevojshme, sipas legjislacionit shqiptar apo të shteteve të huaja, ku mund të ushtrojë aktivitetin e saj.

NENI 6

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k është e **pakufizuar**. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë fillon nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe nëse kërkohet nga ligji, pas marrjes së licencave përkatëse për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

NENI 7

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali bazë fillestari i shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k është **100.000 (një qind mijë) lekë** dhe deklarohet tërësisht i paguar nga ortakët e shoqërisë sipas pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërisë.

Kontributi i ortakëve përbën kapitalin bazë dhe të regjistruar të shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k.

Kapitali i shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k përbëhet nga **2 (dy) kuota**, të cilat kanë vlerën dhe përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë, si më poshtë vijon:

- a) **Z. Denis ORMËNAJ** zotëron pronësinë e Kuotës I, e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k
- b) **Z. Gerti DOKAJ** zotëron pronësinë e Kuotës II, e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k

NENI 8

KONTRIBUTET NË KAPITALIN BAZË TË SHOQËRISË

Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakëve si vijon:

1. **Z. Denis ORMËNAJ** kontribuon në kapitalin e shoqërisë 50%, duke zotëruar 50% të kapitalit të shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k, ose duke zotëruar Kuotën I, e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.
2. **Z. Gerti DOKAJ** kontribuon në kapitalin e shoqërisë 50%, duke zotëruar 50% të kapitalit të shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k, ose duke zotëruar Kuotën II, e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.

Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë, e cila provon zotërimin e kuotave të kapitalit nga ortakët e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim. Sipas nevojës, administratori mund të marrë

vërtetim mbi statusin e kuotave të shoqërisë pranë Regjistrit të Barrëve Siguruese (RBS) dhe/ose çdo institucion tjetër kompetent për këtë qëllim në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çertifikata e lëshuar në emer të personit ose personave që zotërojnë kuotat në këtë shoqëri nuk mund të konsiderohet titull/letër me vlerë dhe/ose të vendoset si garanci. Të gjitha pjesët që formojnë kapitalin bazë, nënshkruhen dhe shlyhen plotësisht nga ortakët e shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k.

NENI 9

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet e shoqërisë “GARAZHI” sh.p.k janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve
2. Administratorët

NENI 10

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Shoqëria “GARAZHI” sh.p.k administrohet nga administratorët e saj:

- 1) **Z. Denis ORMËNAJ**, i biri i Syrjait dhe Anilës, lindur në Kuçovë, i datëlindjes 25.01.2002, me nr.personal K20125002S, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile beqar, i cili ka afat 5-vjeçar.
- 2) **Z. Gerti DOKAJ**, i biri i Rizait dhe Lauretës, lindur në Tiranë, i datëlindjes 18.02.2002, me nr.personal K20218046A, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe me gjendje civile beqar, i cili ka afat 5-vjeçar.

Shoqëria “GARAZHI” sh.p.k do të miratojë shpërblimin e administratorëve, si dhe do të lidhë kontratën e punës me ta, pas krijimit të saj dhe fitimit të personalitetit juridik. Kontrata e punës së administratorit, kur administratori është i ndryshëm nga ortaku i shoqërisë, duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe regjistrohet si e tillë pranë QKB.

Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e tij, si dhe me gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorit në masën e përshtatshme.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Afati i emërimit të administratorit është afati maksimal 5-vjeçar që parashikon legjislacioni në fuqi, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur.

Administratori ka të drejta dhe detyrime në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Administratori është përgjegjës kundrejt shoqërisë ose të tretëve si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të statutit, ose për gabime të kryera gjatë administrimit të tij.

Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Gjithashtu, administratori që jep dorëheqjen, duke patur parasysh rrethanat e veprimitarisë së shoqërisë, është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, përpara datës, në të cilën dorëheqja do të hyjë në fuqi. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar për thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Biznesit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe Qendra Kombëtare e Biznesit regjistron largimin e administratorit. Dorëheqja e administratorit nuk cënon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj. Emërimi i administratorit të ri hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit dhe u kundrejtohet palëve të treta sipas ligjit në fuqi.

NENI 11

PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me ligjin. Administratori, i cili përfaqëson shoqërinë tregtare, mund të autorizohet për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejtpërdrejt ose i deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejtpërdrejt ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligi apo lejon t’u jepet përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë, nëse shoqëria provon se i treti ka patur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte patur dijeni për të. Njoftimet e drejtuara administratorit janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim njoftohet për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave, apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët ose zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës apo mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, do të përmbajnë të dhënat e mëposhtme: numrin unik të



identifikimit, formën ligjore të shoqërisë, vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe zyrës qendrore, numër kontakti, e-mail, faqe internet (nëse ka).

NENI 12

Çdo gjë tjetër më e detajuar parashikohet në statutin e shoqërisë, kopje e të cilit do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe/ose në legjislacionin shqiptar në fuqi për këtë qëllim. Mosmarrëveshjet midis ortakëve do të zgjidhen me mirëkuptim. Në të kundërt, secili prej tyre do t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

THEMELUESIT E SHOQËRISË

“GARAZHI” sh.p.k

Denis ORMËNAJ

Denis ORMËNAJ



Gerti DOKAJ

Gerti DOKAJ

